



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

02-02-2026			
Numri i Aktit	Numri i Aktit	Numri i Aktit	Numri i Aktit
07-110/05	154		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 18 të Ligji Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, dhe neni 6 të Rregullores Nr.0203-1334, e datës 18.12.2012, Rregullores për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2026, miraton këtë:

VENDIM

për nismën e Kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Saint Julien en Genevois - Francë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për nismën për bashkëpunimin ndërkombëtar të Komunës së Vitisë, për të filluar bashkëpunimin ndërkombëtar të qëndrueshëm ndërmjet Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërkombëtar do të zhvillohet me Komunën e Saint Julien en Genevois, në fushën e Sportit, Kulturës, Gjuhës, Bujqësisë, Ekonomisë.

Neni 3

Detajet e bashkëpunimit do të përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

Neni 4

Ky vendim prodhon efekt juridike deri në përfundim të këtij mandati të Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi